

# RAPORT

## Dëgjesë publike për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të Bashkisë Korçë

Sot, më datë 19.12.2016, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak të qytetit, në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë u organizua takimi me grupet e interesit dhe me publikun për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Pjesëmarrës në dëgjesë ishin banorë nga qyteti dhe njësitë Administrative të Bashkisë Korçë, profesionistë të fushës së planifikimit dhe të ndërtimit, grupe të ndryshme interesi, përfaqësues institucionesh, përfaqësues të studios.

Takimi u hap me fjalën e zv/kryetarit të Bashkisë Korçë, Ermal Saraçi, i cili theksoi rëndësinë e hartimit dhe më tej të miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë si një dokument, instrument bazë për një zhvillim të qendrueshëm në fushën ekonomike, të turizmit, si dhe në mbrojtjen e mjedisit.

Gjithashtu theksoi dhe rëndësinë e raportit të vlerësimit strategjik mjedisor si një dokument që do ti paraprijë analizave të mjedisit.

Prezantimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor u bë nga eksperti i studios konsulente, Ing. Gjeolog Sazan Guri. Prezantimi në përmbajtje të tij kishte:

Vizionin e Bashkisë Korçë

Parimin e Planit Strategjik

Legjislacionin

Projektet e kryera dhe kërkesën për shtimin e tyre

Ndotjen e ajrit

Gjeologjia

Gjeorreziqet

Ruajtja e biodiversitetit

Zonat e mbrojtura

Gjeomonumentet

Sipërfaqet e gjelbra dhe monumentet e kulturës

Asetet, si etnografia, antikiteti, veshjet popullore, monumentet arkeologjike

Ujrat e zeza

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Trajtimi i integruar i mbetjeve

Objektivat kryesore, siç mund të jenë mbyllja dhe rehabilitimi i venddepozitimeve, ndërtimi i venddepozitimeve rajonale, etj

Energjia elektrike

Erozioni

Gjeoteknika

Aktivitetet minerale

Analiza demografike

## Analiza SWOT

Ndikimet e rëndësishme të Planit në Mjedis (analizohet me shkallët A,B,C,D,E,X)

Vlerësimi i përputhshmërisë së politikave të Planit me Objektivat Mjedisore

Ndikimet negative dhe masat për zbutjen e ndikimeve negative

Përputhshmëritë me objektivat mjedisore


Përfundime : sistemi i monitorimit.

Janë dhënë mendime për tu marrë parasysh dhe rekomandime për çdo rast, në lidhje me ujin e pishëm, ruajtjen e tokës së bukës, frenimin e rrëshqitjeve, tipologjinë e ndërtimit, korridoret ekologjike urbane, sugjerime për trajtimin e mbetjeve urbane, sugjerime lidhur me rreziqet gjeonatyrore, lidhur me sistemin e dampave minerare, shfrytëzimin e energjisë, etj.





Pas prezantimit, u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilave iu përgjigjën ekspertët e studios konsulente.



- Pyetje – z.Aurel Grabocka : E dëgjova prezantimin dhe nuk pashë të jetë prekur ndotja nga antenat celulare. Është mirë të trajohet sepse këtu në Korçë numri i personave që preken është 300 herë më i madh. Ne bashkë me komisionin këshillimor qytetar vendor dhe me mbështetjen e Bashkisë po kryejmë disa matje, verifikime në lidhje me këtë problem.
- Sazan Guri – Keni të drejtë është prekur shumë pak, por do ta përfshijë edhe këtë problem. Ne ekspozohemi 500 – 1000 herë më shumë me ngarkesë elektromanjetike.
- Pyetje - Isuf Saliçe : Në lidhje me TEC-in, më mirë të mos përmendet fare pasi nga kontrollet rezultojnë shumë shqetësues ajri në Korçë. A mundet të shihen mundësitë e tjera alternative të ngrohjes, si psh ajo diellore, sepse TEC-i krijon ndotje?
- Pyetje – Kristaq Shore : Përmendët që ndotja e ajrit vjen nga djegja e druve të zjarrit dhe është e vërtetë, por si do të zgjidhet? Drutë i presim sot, i djegim sot. Korça ngrohet me dru, si do të furnizohet me lëndë djegëse dhe cilat janë alternativat?
- Eksperti i mjedisit i studios konsulente sqaroi se vitet e fundit ka patur prerje masive të pyjeve, gjë për të cilën qeveria ka miratuar moratoriumin e pyjeve. Variantet për ngrohje dhe energji janë : biomasa që formohet nga landfill-i, vënia në punë e TEC-it (100 MB) që do të bëjë kompesimin e energjisë, stazhionimi i lëndës drusore me qëllim që djegia e saj të ketë efikasitet më të madh dhe ndotje të ulët, kujdesi i njerëzve për mjedisin dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbra. Ekzistojnë projekte për fermat e erës që mund të mbahen parasysht. Një nga zgjidhjet e tjera është edhe termoizolimi i godinave, i cili ndihmon në rritjen e efikasitetit të energjisë. Gjithashtu z.Sazan Guri përmendi eksperiencën e një grupi gjerman i cili ka dhënë zgjidhje se sa lëndë drusore duhet prerë për ngrohje, duke e shprehur këtë gjë nëpërmjet një formule.
- Z.Aurel Grabocka : Bashkë me komisionin qytetar kemi ide për alternativat për ngrohjen. Ndërkohë edhe qeveria duhet të mendojë për alternativat. Do të ishte mirë të bashkëpunonim bashkë siç bëjmë dhe me Bashkinë.

Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit  
dhe Zhvillimit të Territorit

Zhaneta Lubonja



Drejtoreshë e D.P.K.ZH.T.